VENDIM
Nr. 448, datë 27.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 381, DATË 6.5.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË FORUMIN EKONOMIK TË VJENËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", dhe të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 4, e vendimit nr. 381, datë 6.5.2015, të Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama